

## FJALA E DEPUTETES ANDIA ULLIRI E HËNË 23 TETOR 2021

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Imagjinoni të zgjoheshit në mëngjes dhe të shihnit që tokat tuaja janë përmytur brenda natës; të investonit në bujqësi dhe prodhimet tuaja të thahen nga mungesa e ujit vaditës; të shihnit se rrugët janë të pashtruara dhe çmimi i naftës është më i larti në rajon; të frekuentoni shkollat publike dhe të kuptoni se ato ambiente janë të pamjaftueshme për të zhvilluar një mësim normal kur ministria kërkon distancim social; të hapni qepenin e biznesit tuaj dhe t'ju kenë faturuar me çmimet më të larta të energjisë elektrike; të paguani taksën për mjedisin teksa plehrat digjen dhe depozitohen disa metra pranë pragut të derës suaj. Kjo, të dashur qytetarë, është jeta e banorëve të zonës Fushë- Krujë, Nikël dhe Bubq. Kjo do të thotë të jetosh fare pranë kryeqytetit dhe realiteti të godasë ndryshe në çdo aspekt jetësor. Qeveria në mandatin e saj të parë erdhi me disa premtime, premtime të harruara, të cilave kujtohen t'u rikthehen vetëm në prag të fushatës tjetër elektorale. Jemi ne vitin 2021, por "rilindja" ende përmend premtimet e vitit 2013 dhe vitit 2015, premtime si kryerja e rikonstruksionit të shkollës filllore "Vesel Brama" në Kurcaj, ku do të evidentoj faktin që shkolla zhvillon mësim me turne, si rrjedhojë e mungesës së kapaciteteve. Kjo shkollë jo vetëm që nuk pati investimin e merituar ndër vite, por nuk u përzgjedh as në programin e rindërtimit pas dëmtimeve që pësoi nga tërmeti i 26 nëntorit, ku qartësisht, duke qenë një nga objektet më te vjetra në zonë, duhet të ishte marrë parasysh. Arsimi dhe tregu i punës së fundi kanë rezultuar në një mospërputhje të vazhdueshme dhe kjo ka sjellë edhe largimin masiv të të rinjve drejt vendeve të huaja për mundësi, të cilat qeveria, fatkeqësisht, nuk ua mundësoi dot në këto dy mandate. Që të parandalohet kjo problematikë u ngritën edhe shkollat profesionale, me qëllim përputhjen e interesave të tregut të punës me të rinjtë në zona me industri të zhvilluar, siç është Fushë- Kruja. Me përmylljen e disa problemeve lidhur me arsimin, siç ishin mungesa e kapaciteteve dhe lënia në harresë, do të shtoja vizitën e Kryeministrit Rama më 28 shtator në shkollën publike "Korb Muça" në Qerekë. Si arkitekthe do ta përgëzoja UNDP-në për realizimin e këtij objekti, ku detyra e vetme e qeverisë ishte furnizimi me ujë dhe energji elektrike nga OSHEE-ja Tiranë. Sot kjo shkollë ende nuk ka arritur të furnizohet me energji elektrike jo vetëm si pasojë e problemeve të rrjetit shpërndarës, i cili vazhdimisht ka shpëputje dhe luhajtje të energjisë që përcjell, por edhe si pasojë e neglizhencës së theksuar nga ana e qeverisë në përmbushjen e detyrimeve të vetme që kishin ndaj këtij komuniteti. Në njërën anë përballemi me çmime të larta të energjisë elektrike, ndërkohë që ekzistojnë zona, të cilat nuk furnizohen prej vitesh. Neglizhencë e qeverisë nuk është vetëm investimi në arsim, por edhe mungesa e investimeve në infrastrukturë. Fillimisht do të përmend premtimet për një infrastrukturë moderne drejtuar fshatit Bubq, ku interesant do të gjeni faktin që fshati Bilaj disponon burimin e ujit, i cili me anë të ujësjellësve furnizon qytetin e Durrësit, por jo banorët e saj. Ky është një problem, i cili shoqëron edhe banorët e Mallkuçit, Mazhë e Vogël, Mazhë e Madhe dhe Budull, ku kjo e fundit vuan lidhjen e rrjetit shpërndarës së ujësjellësit me shtëpitë e banorëve. Nuk dua ta lë pa përmendur edhe mungesën e theksuar të seriozitetit kur bëhet fjalë për investimin në ndërtimin e Urës së Tubit dhe rregullimin e rrugës përkatëse që lidh Niklën me aeroportin "Nënë Tereza", po ashtu edhe

mungesën e investimit në shtrimin e rrugës kryesore, që mundëson lidhjen e Kurcajit me Niklën. A mund të më thoni e dashur, qeveria "Rama", si është e mundur të premtohen investime në fushën e kulturës, kur hapi i parë i qeverisë suaj ishte mbyllja e qendrës kulturore bashkë me bibliotekën e qytetit, të cilat janë të mbyllura prej 8 vjetësh? Me sa duket qeveria nuk e pa të arsyeshme nevojën e një qendre kulturore në një zonë me 36 mijë banorë. Si mund të lejohet depozitimi dhe djegia e plehrave 20 metra larg rrugës kryesore të qytetit? Për depozitimin e mbeturinave në lagjen Kameraz janë bërë disa denoncime. Pra, për shkak të mosmenaxhimit të kësaj situate nga qeveria, janë bërë kërkesa dhe raportime të shumta nga qytetarët, sepse ditaditës shkaktohen ndotje. Duke përmbyllur disa nga problematikat e kësaj zone, i bëj thirrje pushtetit qendror dhe atij lokal të marrin masat e duhura në zgjidhjen e këtyre problemeve dhe të ndërjegjësohen në plotësimin e detyrave të tyre ndaj qytetarëve. Se fundi, dua t'i drejtoj një pyetje zotit Edi Rama: a do të jenë satelitë, të cilët ju po i përdorni tashmë, për t'ua larguar vëmendjen qytetarëve nga e vërteta e hidhur që i shoqëron çdo ditë, nga zgjidhja e problemeve të tyre? A do të na i ulin satelitët çmimet e shportës, apo do të na ndihmojnë në raportin e çmimeve të naftës dhe energjisë elektrike?! Faleminderit!